

DREJTUAR: Hekurudha Shqiptare

Adresa: Rruga "Egnatia", Nr. 3, Durrës

Për dijeni: *Koordinatorës për të drejtën e informimit, Znj. Paula Vatnikaj*

OBJEKTI: **Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit**

BAZA LIGJORE: Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

E nderuar Znj. Koordinares,

_____ është e angazhuar t'i shërbejë publikut për të bërë transparencën e institucioneve e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në mirëqeverisjen e vendit. Në shërbimin online www.publeaks.al ka mbërritur kërkesa e një qytetari për t'u informuar në lidhje me:

- Cila është gjendja aktuale e punimeve të Hekurudhës Tiranë-Durrës me zgjatim në Rinas?
- Cili është statusi i ndërtimit të godinave të stacioneve, sa prej tyre janë përfunduar, po ndërtohen, dhe sa prej tyre nuk kanë nisur ndërtimi?
- A ka nisur procesi i ndërtimit të zgjatimit të Hekurudhës drejt ish-Stacionit të Trenit (Bulevardi i Ri në Tiranë)?
- Cilat janë pritshmëritë e projektit për vitin 2026?
- A ka shprehur ndonjë kompani interes për operimin koncesionar të hekurudhës dhe nëse po nga cili shtet?

Kjo kërkesë bazohet në nenin 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:

"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."